

VENDIM
Nr.241, datë 21.4.2005

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË LEGALIZIMIT DHE URBANIZIMIT TË ZONAVE INFORMALE DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.440, DATË 26.6.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NGRITJEN E AGJENCISË SË URBANIZIMIT TË ZONAVE INFORMALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 13, pika 1 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Legalizimit dhe e Urbanizimit të Zonave Informale (ALUZI), (më poshtë agjencia), funksionon si pjesë e strukturës së ministrisë, që mbulon këtë fushë.

2. Agjencia është struktura përgjegjëse, që monitoron dhe ndjek zbatimin e legjislacionit në fushën e planifikimit të territorit dhe konkretisht për:

a) Legalizimin e ndërtimeve pa leje; b) urbanizimin e zonave informale; c) zhvillimin e zonave urbane të degraduara.

3. Agjencia drejtohet nga drejtori dhe në organikë ka specialistë, të cilët emërohen dhe lirohen nga ministri, që mbulon fushën e planifikimit të territorit, në përputhje me procedurat dhe kriteret e ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, por nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

4. Agjencia kryen këto detyra:

a) Bashkëpunon dhe bashkërendon punën me organet qendrore shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për zbatimin e ligjit nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”;

b) Studion dhe verifikon ecurinë e procesit të legalizimit dhe të urbanizimit të zonave informale, si dhe planifikon fondet buxhetore të KRRTRSH-së për financimin e këtij procesi;

c) Raporton, nëpërmjet sekretarisë teknike, në KRRTRSH për çdo fazë të procesit të legalizimit dhe të urbanizimit të zonave informale, si dhe propozon marrjen e masave konkrete;

ç) Harton dhe propozon për miratim në KRRTRSH kriteret e format urbanistike integruese për zhvillimin e zonave informale apo të zonave urbane të degraduara;

d) Kontrollon zbatimin e studimeve urbanistike të miratuara, sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 9 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, dhe i propozon KRRTRSH-së lëshimin e autorizimit për fillimin e legalizimeve në zonën informale përkatëse;

dh) Përcakton procedurat për legalizimin e ndërtimeve pa leje, si dhe ndjek zbatimin e tyre;

e) Propozon, mbështet dhe zbaton politikat e qeverisë për zhvillimin e zonave urbane të degraduara;

e) Bashkërendon punën me sekretarinë teknike të KRRTRSH-së për vlerësimin e propozimeve të njësive të qeverisjes vendore për zonat informale, sipas përcaktimit të nenit 8 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004;

f) Bashkërendon punën me njësitë e qeverisjes vendore në zbatim të ligjit nr.8652, datë 31.7.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, dhe me ISPU-në për hartimin e studimeve urbanistike të zonave informale, të veçanta, në zbatim të vendimit nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, të ndryshuar, dhe përgatit materialet për Këshillin e Ministrave, në përputhje me shkronjën “e” të nenit 8 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004.

5. Veprimtaria e brendshme e agjencisë rregullohet me rregulloren përkatëse të miratuar nga ministri, që mbulon fushën e planifikimit të territorit.

6. Në vendimin nr.440, datë 26.6.2003 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e Agjencisë së Urbanizimit të Zonave Informale”, të bëhen këto ndryshime:

a) Emërtimi “Agjencia e Urbanizimit të Zonave Informale” të zëvendësohet me “Agjencia e

Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale”;

b) Pikat 1, 2, 3, 4, 6 e 7, shfuqizohen.

7. Ngarkohet Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano